



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

**Rasti: Media Vizion SHA – OST Holding Gmbh- Media Holdings
Beteiligungs.**

Në datën 02 Korrik 2012, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me objekt ndyshimin e kontrollit në shoqërinë Media Vizion Sha nëpërmjet transferimit të aksioneve të OST Holding Gmbh dhe Media Holding Beteiligungs AG tek aksionerët e tjere.

Ky transaksion i përbërë nga dy faza konsiston në:

- a. Transferimin e 40% të aksioneve të aksionerit OST Holding Gmbh tek aksionerët e tjere, Adrian Dulaku, Artan Dulaku dhe Genc Dulaku.
- b. Transferimin e 27% të aksioneve të aksionerit Media Beteiligungs AG tek aksionerët e tjerë, Adrian Dulaku, Artan Dulaku dhe Genc Dulaku.

Shoqëria Media Vizion ushtron veprimtari në fushën e transmetimeve radio televizive me shpërndarje me anë të valëve dhe via kavo

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al